



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 15 Më 04.01.2023
Br. prot. Dt. 23
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Datë/a	05.01.2023
Referencë/a	
Për/Za?To :	Z. Smajl Latifi - Kryetar i K. Rahovec
CC:	Z. Fatmir Iska Nënkyetar i K. Rahovec
Përmes/Prekp/Through:	Drejtëpërdrejt
Nga/Od/From :	Z. Afrim Oruqi Jurist i Diplomuar Drejtë i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raport i punës për periudhën Janar- Dhjetor 2022



Raport i punës për periudhën Janar- Dhjetor 2022

Nga: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2022 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2022.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	1224	30,420 €
Gjeodezi	1,920	25,700 €
Referenti	3,018+140 L.Z.	16,740 €
Totali	6,274+140 L.Z.	72,860 €

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor i kemi përfunduar këto punë:

Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privat për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, cregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajtshmëris, ndarje e bashkësisë familjare etj. Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje plani.

Barazimi financiar me drejtorin e financave për muajin Janar- Dhjetor të vitit 2022.

Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si koordinata, modifikime dhe punë tjera, të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve.

Pergjigje në kërkesat e përfaqësuesit ligjor të Komunës në lidhje me shënimet sipas lëndëve në procedurë gjyqësore dhe padive.

Me kërkesë të qytetarëve për shpronësim të pronës private- rrugë e kalueshme në terren ZK Rahovec kemi dalë në terren me gjeodet dhe kemi pregatitur Historiat të parcelave në fjalë. Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe aprovaur me kohë në intranet, gjatë javës së dytë të muajit janar kemi pranur dy kërkesa për fajle të pronës private në pronë publike për hapje të rrugës, gjeodetë kanë dalë në terren, janë kufizuar parcelat në fjalë dhe janë marrë deklaratat nga palët për falje të pronës.

Gjatë javës së tretë të janarit kemi vlerësuar punëtorët në afat ligjor për vitin 2021. Kemi evidentuar të gjitha pronat që janë në territorin e komunës së Rahovecit e që janë në menaxhim të AKP-së dhe kemi pregatitur një raport të detajuar për secilën parcel, zonë dhe sipërfaqe të pronave. Kemi pranuar kërkesë nga drejtoria e ekonomisë për evidentimin e pronave në disa

zona si Krushë e Madhe, Ratkoc dhe Xërxë për caktimin e lokacioneve për zonat e vogla ekonomike.

Kemi publikuar në afat ligjor listën e përgjithshme të pronave dhe listën e veçantë të pronave, të cilat planifikojmë për dhënie me qira në nivel komune brenda vitit 2023.

Kemi mbajtur takimet e rregullta me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

Përgjigje në kërkesat e zyrës ligjore sipas nevojës.

Kemi pranuar kërkesa nga këshillat e fshatrave për kufizime të rrugëve, varrezave, pronave publike dhe parcelave tjera si në ZK Guri i Kuq, Senoc, Rahovec etj. Një punëtor administrativ nga sektori i kadastrit e kemi bartur me zyre në katin e parë të administratës dhe nga kjo javë ofrohen produktet për qytetarë si certifikatat e pronës, evidentimi i parcelave dhe shërbime tjera, planifikojmë deri në fund të vitit të nxjerrim edhe kopjen e planit në këtë zyre edhe në katin e parë të administratës.

Gjatë javës së katërt të Janarit kemi evidentuar të gjitha pronat që janë në territorin e komunës së Rahovecit e që janë në menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës dhe kemi përgatitur një raport të detajuar për secilën parcel, zonë dhe sipërfaqe të pronave.

Me kërkesë nga keshilli i fshatit Guri i Kuq, kemi dalë në terren me gjeodet dhe kemi kufizuar parcelën me nr. 01126-0 rrugë. Përgjigje në kërkesat e Avokatit të Komunës në lidhje me shënimet sipas lëndeve në procedurë gjyqësore.

Me kërkesë nga drejtoria e arsimit, kemi dalë në terren me gjeodet dhe kemi kufizuar parcelën në ZK Rahovec dhe kemi përgatitur dokumente si: situacionin e terrenit, certifikatën e pronës dhe kopjen e planit për parcelën ku ideohet të ndërtohet cerdhja e fëmijëve. Kemi përfunduar evidentimin e pronave që menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës në nivel Komune.

Sipas planit të Kuvendit Komunal, kemi përgatitur material të nevojshëm për Komitetin për Politikë dhe Financa. Takim me zyrtar të AKP-së në Prizren. Përfundimi i Historiateve të parcelave sipas kërkesës zyrtare.

Gjatë javës së tretë të Shkurtit, kemi përfunduar Historiatin e parcelave në ZK Rahovec te stacioni i autobusave dhe e kemi kufizuar parcelën sipas kërkesës së drejtorisë së Ekonomisë. Me kërkesë të inspektoratit kemi dalë në terren me gjeodet dhe zyrtar të pronës e kemi inkuizuar parcelën dhe objektin në ZK Rahovec kemi nxjerr vendim dhe janë njoftuar palët në procedurë. Kemi përgatitur një raport detal me pronat komunale në 34 Zona Kadastrale në nivel të komunës. Kemi pranuar kërkesë nga këshilli i fshatit Senoc për dalje në terren dhe kufizim të parcelës në ZK Senoc.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka përfunduar raportin detal me prona të uzurpuara publike në 34 Zona Kadastrale në nivel të Komunës. Me kërkesën tonë kemi nënshkruar marrëveshje me AKK-në në Prishtinë në lidhje me shërbimet e Koposit. Pergjigje në afat ligjor kërkesave të qytetarëve. Takim i rregullt me zyrtar të Agjencionit në lidhje me lëndë që janë kontestuese. Sipas kërkesës së keshillit të fshatit Senoc kemi dalë në terren dhe kemi kufizuar parcelën sipas kërkesës. Kemi pranuar kërkesë nga inspektorati për dalje në terren në ZK Dabidol për konstatim se a ka uzurpim të pronës publike në parcelën në fjalë.

Kemi pritur në takim përfaqshues të AKK-së ku së bashku me Kryetarin e Komunës Z. Latifi kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për sistemin e adresave REGIP. Me kërkesë të drejtorisë së Ekonomisë kemi parcelizuar zonën ekonomike.

Me kërkesa zyrtare kemi dalë në terren dhe kemi kufizuar varrezat e fshatit Senoc, stacionin e autobusave në qytet, dalje në terren me kërkesë të inspektoratit në të gjitha Zonat Kadastrale, kufizimi i parcelës në Hoqë të Vogël, dalje në terren dhe kufizimi i rrugëve fushore sipas kërkesës së drejtorisë së bujqësisë, dalje në terren në ZK Fortesë (kufizimi i rrugës katër korsi), kufizimi i përrockës në Z.K. Celinë, kufizimi i rrugës "Flamuri" në ZK Xërxe, kufizimi i rrugës në ZK Malësi e Vogël, kufizimi i parcelave te depo në Xërxe etj. Prgatitje e materialit të nevojshëm për Komitetin për Politik dhe Financa.

Kemi përfunduar të gjitha lëndë të legalizimit sipas afateve ligjore. Aprovimi i kërkesave për dalje të pronës private për hapje të rrugëve në nivel të komunës.

Kemi përgatit shkresa zyrtare Agjencionit Kosovar të Privatizimit që t'i heq nga shitja asetet, të cilat janë në interes të përgjithshëm të komunës dhe i kemi drejtuar ministrive përkatëse për fillimin e procedurave për shpronësim të parcelave me interes të përgjithshëm. Me kërkesë të zyrtarëve të paraburgimit të Prizrenit dhe Istogut kemi dalë në terren dhe kemi evidentuar nga afar parcelat të përshtatshme për ndërtimin e objekteve të nevojshme për institucionin në fjalë në tre zona kadastrale.

Kryetari i Komunës z. Latifi ka nënshkruar memorandum me përfaqshues të USAID-it për menaxhim të pronës, ku është formuar edhe komiteti për politikën e mira për menaxhimin e pronës ndërmjet pesë komunave përfutuese nga projekti në fjalë, AKK-ja dhe ministrit përkatëse.

Në bashkëpunim me AKK-në i kemi kryer të gjitha punët sa i përket nxjerrjes së certifikatës së pronës edhe në EKIOSK.

Dhe punë tjera sipas kërkesave të palëve.

Me respekt,

Afrim Oruqi

Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Komuna Rahovec

Mob: +377 (0) 45 134 006

Ctx: +381 (0) 3820045311

afrim.oruqi@rks-gov.net

